



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA JURIDIKE, PROKURIMEVE DHE PRONAVE
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË PRONAVE DHE STREHIMIT

PROJEKT - PROPOZIM

Nr. 10, datë 24.12.2025

**“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË,
SIPAS STRUKTURAVE TË APARTAMENTEVE”**

Mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit në mbledhjen e Këshilit Bashkiak të datës, _____.2025

PROPOZON

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare të apartamenteve në treg, për efekt subvencionimi të qirasë:

a) Për apartament të tipit “Garsonierë”	6,000	lekë/muaj
b) Për apartament të tipit 1+1	12,000	lekë/muaj
c) Për apartament të tipit 2+1	15,000	lekë/muaj
d) Për apartament të tipit 3+1	18,000	lekë/muaj

2. Miratimin e vlerës të qirasë vjetore për vitin 2026, për apartamentet e programit “Banesë sociale me qira”, me vlerën 88 lekë/m² në muaj;
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit, Bashkia Dibër;
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e institucionit të Prefektit, Qarku Dibër;

**Përgjegjës i Sektori të Administrimit të
Pronave dhe Strehimit**

Gazmend Miftari

Drejtori Juridik

Ismet Saraçi

KRYETARI
Rahim SPAHIU

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Lorenc Cibaku

**RELACION SHPJEGUES
PËR PROJEKT - VENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË,
SIPAS STRUKTURAVE TË APARTAMENTEVE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 362, datë 29.5.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasënë tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, bazuar në instrumentin financiar “në mungesë të banesave sociale, ofrohet subvencionimi i qerasë në tregun e lirë”, është bërë njoftimi “Thirrje për aplikime dhe dokumentacioni i nevojshëm, i përditësuar, për risubvencionim për vitin pasardhës nga përfituesit ekzistues dhe aplikuesve të rinj, për përfitimin e subvencionimit për vitin 2026” me nr. 4576 prot., datë 11.11.2025, për të gjithë qytetarët e Bashkisë Dibër që janë interesuar për këtë program, të paraqesin kërkesën e tyre dhe dokumentacionin e nevojshëm, nëpërmjet llogarisë së tyre të e-Albania, në shërbimin “Kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social”. Shpenzimet mesatare do ti referohen shkresës së MEKI nr. 12836 Prot., datë 13/11/2024, adresuar Bashkisë Dibër, “Për vlerësimin e nivelit të të ardhurave mesatare të familjeve”, të dhëna që do të përdoren për vlerësimin e nivelit të të ardhurave të familjeve sipas nenit 2, pika 45 ligjit “Për strehimin social”.

Bazuar në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, neni 35, pika 1 dhe 2, përcaktohen procedurat për administrimin e kërkesave për planifikimin e fondeve nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë:

1. Brenda muajit nëntor të çdo viti rishikohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikimet dhe dokumentacioni i nevojshëm, i përditësuar, për risubvencionim për vitin pasardhës nga përfituesit ekzistues dhe i përcillen ministrisë përgjegjëse për strehimin.
2. Kërkesat e aplikuesve të rinj, për përfitimin e subvencionimit, mund të paraqiten në çdo kohë gjatë vitit, por jo më vonë se muaji nëntor për vitin pasardhës.

Sipas nenit 73, germa dh:

dh) Brenda muajit janar të çdo viti, njësia e vetëqeverisjes vendore paraqet pranë ministrit përgjegjës për strehimin kërkesën për financime, investime dhe subvencione, sipas këtij ligji, nga fondet e buxhetit të vitit korrent, shoqëruar me informacionin, i cili përmban:

- i) numrin e familjeve të regjistruara për t’u trajtuar me programet sociale të strehimit;
- ii) numrin e familjeve që janë trajtuar brenda një viti;
- iii) të ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore, që do të përdoren për programet sociale të strehimit.


Me qëllim përcaktimin e qirasë mesatare të apartamenteve në treg për strukturën që i takon familjes për vitin 2026 dhe thirrjes së përvitshme që hapet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit mbi fondet për subvencionimin e qirasë, ku për të përfituar fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të plotësojë kushtet ligjore si më poshtë:

- të ketë miratuar nivelin e qirasë mesatare në treg të lirë, sipas strukturave të apartamenteve, me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Në këtë kuadër, kërkohet të jepet miratimi i nivelit të qirasë mesatare të apartamenteve në treg, për efekt subvencionimi të qirasë dhe miratimin e vlerës të qirasë vjetore për vitin 2026, për apartamentet e programit “Banesë sociale me qira”.

Sektori i Pronave dhe Strehimit

Specialist
Mentor Bitri



Specialist
Xhesika Rama



Përgjegjës
Gazmend Miftari

